

V E N D I M
Nr.89, datë 14.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.95 Akti që i përket:

KËRKUESE: MIMOZA AHMETI, kandidate për deputete e koalicionit “Bashkimi për Fitore” në zonën zgjedhore nr.43.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. MONIKA KRYEMADHI, kandidate për deputete e Partisë Socialiste, përfaqësuar me prokurë nga avokat Agim Muça.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.43, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.944, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kërkuesja ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit të Tiranës nr.72, datë 22.6.2001 është i paligjshëm dhe antikushtetues, sepse ajo Gjykatë nuk ka të drejtë të anulojë vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të mënjanojë gjykimin në gjykatën e shkallës së parë.

- Më është mohuar e drejta e ankimit të vendimit të gjykatës së apelit.

- Gjatë procesit të rishikimit të listave të zgjedhësve, u evidentuan një numër i madh prej tyre të regjistruar në dy lista zgjedhësish, si dhe zgjedhës të paregjistruar fare.

- Gjatë punës në Komisionin e Zonës Zgjedhore, është zhdukur nga sekretarja Fletorja e Protokollit të Mbledhjeve të Komisionit.

- Janë shkelur haptazi normat e Kodit Zgjedhor për mënyrën e shpalljes së rezultatit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesen, subjektet e interesuara, administroi provat dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.43 Tiranë, në bazë të procesverbaleve të ardhura nga komisionet e qendrave të votimit, ka shpallur deputete të drejtpërdrejtë zonjën Monika Kryemadhi me vendimin nr.007, datë 25.6.2001. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesja Mimoza Ahmeti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe ky i fundit, me vendimin nr.944, datë 28.6.2001, ka shpallur rezultatin përfundimtar të asaj zone, duke njohur si fituese kandidaten e shpallur nga Komisioni i Zonës Zgjedhore. Të dy këto vendime harmonizohen me përmbajtjen e tabelave të rezultateve të nxjerra nga komisionet e qendrave të votimit të nënshkuara rregullisht nga anëtarët e komiseve.

Kërkuesja nuk paraqiti prova për të vërtetuar se janë shkelur rregullat e parashikuara në nenin 107 të Kodit Zgjedhor për hapjen e kutive të votimit e për verifikimin në to të vulave, procesverbaleve

origjinale, fletëvotimeve, etj. Përkundrazi, edhe komisionerët e propozuar nga partitë e koalicionit “Bashkimi për Fitore”, nuk kanë bërë vërejtje të tilla në procesverbalet përkatëse dhe mbi të gjitha vetë kërkuesja nuk pretendoi që procesverbalet origjinale të ndodhura në kuti të kenë të dhëna të ndryshme nga procesverbalet e marra prej saj.

Pretendimet e tjera të kërkueses për ndryshimin e përbërjes së komisioneve me vendim të paligjshëm e antikushtetues të Gjykatës së Apelit apo për zhdukjen e fletores së protokollit nga sekretarja nuk provuan të kenë sjellë ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin e votimit. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, Gjykata e Apelit, sipas nenit 142 të Kodit Zgjedhor, është kompetente për të shqyrtuar ankimet kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo Gjykatë, pasi shqyrtoi çështjen, vendosi shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilin ishte pranuar lista emërore e komisionerëve të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, të paraqitur nga partia në qendër, duke konsideruar si të vlefshme listën e komisionerëve të paraqitur nga dega e partisë për Tiranën.

Përsa i përket mangësive e parregullsive në listat e zgjedhësve jo vetëm që nuk mund të nxirret konkluzion për ndikimin e tyre në fitoren apo humbjen e çdo kandidati, por, sipas nenit 143 të Kodit Zgjedhor, çdo zgjedhës që nuk është regjistruar në listat e zgjedhësve mund të ankohet në gjykatën e rrethit, jo më vonë se 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Në këtë mënyrë, ishin të gjitha mundësitë që të mos i cenohej askujt e drejta e zgjedhjes.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/e të Kushtetutës; nenit 140 të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.